



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues nacional (MPN) më datë **15.07.2016** realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në SP Resnjë (vizitë e parë nga ana e ekipit të MPN-së në këtë stacion policor), në suaza të mandatit dhe kompetencave të cilat dalin nga Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, çnjerëzor, nënçmues ose ndëshkues dhe Ligjit për Avokatin e Popullit. Vizita u realizua në bashkëpunim me bashkëpunëtorin e jashtëm të Shoqatës për të drejtën penale dhe kriminologji në Maqedoni, me të cilën Avokati i Popullit ka lidhur memorandum për bashkëpunim.

Qëllimi i vizitës, konform Protokollit fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, çnjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, ishte identifikimi i rreziqeve eventuale me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, çnjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Gjatë vizitës së stacionit policor u realizuan biseda me udhëheqësit e turnit të SP-Resnjë, u analizuan kushtet materiale në vendet e ndalimit, u bë këqyrje në evidencën e regjistrave dhe procesverbalet e veçanta për persona të arrestuar dhe të ndalur, ndërkaq u bë inspektim edhe në hapësirat e tjera dhe zyret e punonjësve të stacionit.

Gjatë kohës së vizitës në SP-Resnjë nuk kishte asnjë person të arrestuar ose të ndalur me të cilin MPN-ja do të mundeshte të realizojë bisedë për kushtet e qëndrimit në stacionin policor dhe vendin ku personi i privuar nga liria qëndron gjatë kohës së ndaljes së tij në këtë stacion policor.

Gjatë shetitjes rreth e përfaq në hapësirën për ndalje, hapësirën për pranim (zyra e udhëheqësit të turnit) dhe zyrat tjera zyrtare, ekipi i MPN-së nuk hasi në mjete ose sende tjera të dyshimta me të cilat mund të bëhet frikësimi i personave të privuar nga liria ose me të cilat do të mundeshin personat e privuar nga liria të lëndojnë vetveten.

Lidhur me hapësirat për ndalje, ekipi i MPN-së pranoi informatë se vetëm një hapësirë për ndalje shfrytëzohet dhe është funksionale, ndërsa 3 hapësira të tjera janë jofunksionale dhe nuk i plotësojnë standardet minimale të parashikuara për ndaljen e personave, edhe pse nga inspektimi në të njëjtat fitohet përshtypja se edhe ato shfrytëzohen për këtë qëllim.

Konform informatave të pranuar nga zyrtarët policor, në rast të privimit nga liria, personi çdoherë njoftohet me arsyet e privimit të tij dhe udhëzohet për të drejtat e tij.

Për vizitën Mekanizmi parandalues nacional hartoi raport të veçantë në të cilin konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime konkrete pranë Ministrisë për punë të brendshme, si dhe pranë kryeshefit të stacionit policor në Resnjë me qëllim që të eliminohen mangësitë e cekura dhe të përmirësohen kushtet dhe trajtimi i personave të privuar nga liria, personave të arrestuar dhe të ndalur.